

KUSH JEMI:

HISTORIA

Shoqëria Ndhimë për Gruan – Të Dalim nga Dhuna - ka lindur brenda Këshillit të Grave të Komunës së Bergamo-s, një organ me pjesëmarrje femërore i krijuar nga Këshilli Komunal në vitin 1996.

Ky organ, që nga krijimi i tij, ka pasur si qëllim të ndikojë në zgjedhjet e administratës, për të vënë në dukje prezencën e grave në qytet, të promovojë iniciativa kulturore të cilat kanë qëllim rritjen e subjektivitet, të krijojë një rrjet komunikimi dhe marrëdhëniesh.

U krijuan katër Komisione, një nga të cilat merrej pikërisht me shqetësimin femëror.

Nga studimi i bërë, doli nevoja për të përballuar me mjete të përshtatshme një problem shumë të përhapur aq dhe të fshehur: dhuna brenda familjes dhe jashtë familjes në dëm të grave.

Ndryshe nga sa i përket pjesës tjetër të territorit rajonal, u nënvizua mungesa në provincën tonë, e organizatave të cilat merreshin me këtë problem.

E shtyrë edhe nga shumë përvoja të ngjashme në qytete të tjera, komisioni 3-të i Këshillit të Grave i propozoi Prezantuesit të Politikës Shoqërore një projekt të saktë për t'i dhënë mbështetje dhe ndihmë grave, viktimave të dhunës. Kështu në prill të vitit 1999 u krijua Shoqata "Ndhimë për Gruan – të dalim nga dhuna" me 18 anëtare themeluese: nëna, mësuese, edukatore profesionale, psikologe, asistente sociale, profesionale, të bashkuara nga një ndjeshmëri e përbashkët dhe një ecuri formimi, për sa i përket problemit të dhunës fizike, psikike, seksuale dhe ekonomike që ushtrohet mbi gratë.

PROJEKTI:

OBJEKTIVAT

Ndjenja që i ka dhënë gjithmonë jetë Shoqatës ndihmë-gruas, ka qenë ajo e mikpritjes.

Për këtë, qëllimi i parë që kjo shoqatë kishte, ishte ai që të krijonte një vend dëgjimi, në të cilin gratë në vështirësi mund të drejtoheshin lirisht, me garancinë anonime, në respekt të identitetit të tyre kulturor dhe fetar. Një vend mikpritje në të cilin gratë të cilat vuajnë dhunën mund të gjejnë solidaritet, ngrohtësi, neutralitet dhe kompetencë.

Gjithashtu janë vënë në dispozicion shërbime të cilat japin mirëpritje e këshillime të hollësishme (ligjore dhe psikologjike) grave të cilat bëjnë kërkesë.

Qëllimi i dytë ishte nisja e një iniciative informacioni për sa i përket fenomenit të dhunës mbi gratë, nëpërmjet iniciativave të prezantimit publik të Shoqatës: ekspozitave, shfaqjeve, publikimeve, organizimit të Seminareve dhe të kurseve për

të gjithë personat e interesuar dhe që duan të japin kontributin e tyre për parandalimin, ndihmën dhe kujdesin për pasojat që shkaktojnë këto probleme.

AKTIVITET E ZHVILLUARA

Gjatë këtyre viteve të këtij aktiviteti, gjithashtu është zhvilluar një punë e vazhdueshme formim/drejtimi i përgjithshëm i vullnetareve, të cilat me angazhim e zotësi kanë punuar për këtë projekt. Pikërisht, kontakti pothuaj i përditshëm me vuajtjet i shprehur nga gratë, të cilat jetojnë në ambiente të kushtëzuara nga dhuna, ka nënvizuar nevojën e zhvillimit të kompetencave të posaçme në lidhje me lëvizjet objektive të vetëdijshme ose të pavetëdijshme që komandojnë këto marrëdhënie.

Nga këto momente studimi e përpunimi, që në vitin 2001, lindi ideja për të krijuar një grup vetë-bashkë-ndihmë. Gratë që dëshirojnë takohen tek Shoqata, një herë në javë, për të shkëmbyer përvojën e tyre të jetës, emocionet dhe ankthet e tyre. Në epokën e komunikimit telematik, në të cilën duket se janë hequr pengesat e komunikimit, sepse është bërë i mundur transmetimi i mendimit në një kohë reale, pavarësisht nga kufizimet hapësinore, vetmia rezulton shumë e përhapur.

EKIPI

Ekipi siguron mirëpritje për të gjitha gratë, për të dalë nga situata e dhunës psikologjike, fizike ose ekonomike **nëpërmjet prezencës së figurave profesionale të ndryshme; edukatore, avokate, psikologe dhe operatore të mikpritjes.**

FALËNDERIMET

Shoqata, më 16 dhjetor 2006, ka marrë një diplomë nderi për merita shoqërore nga Administrata Komunale e Bergamo-s.

ÇFARË TË OFROJMË

Shërbim Telefonik

Operatoret tona i marrin telefonatat në numrin 035212933 nga ora 9.30 deri në orën 12.30 nga e hëna deri të premtën, dhe nga ora 15.00 deri në orën 17.00 të mërkurën dhe të enjten.

Përveç kësaj, me anë të një sekretarie telefonike e cila funksionon për 24 orë rresht, mund të lihet personalisht një mesazh.

Gjatë telefonatës operatoret mundohen të kuptojnë se çfarë tip kërkesë paraqet gruaja dhe çfarë situatë po jeton. Për të pasur mundësinë për ta ndihmuar, është e nevojshme të caktohet një takim mirëpritjeje pranë selisë së Shoqatës.

BISEDIME MIRËPRITJEJE

Zhvillohen pranë selisë tonë, në prezencë të dy operatoreve vullnetare. Ky shërbim kryhet nëpërmjet takimit të fiksuar gjate telefonatës dhe vetëm me dëshirën e plotë të gruas.

Gjate takimeve të mirëpritjes (zakonisht janë dy ose tre) së bashku me gruan caktohet një projekt, i cili ka si qëllim ta ndihmojë për të gjetur rrugën për të dalë nga spiralja e dhunës dhe marrëdhëniet e përcaktuara si mazokiste (vetë-dëmtuese). Në këtë rast propozohen këshillimet me specialistët.

KËSHILLIM PSIKOLOGJIK

Qëndron në disa takime (2/3) individuale me psikologun e cila në bashkëpunim me gruan do kërkojë të kuptojë profilin e personalitetit të gruas. Kjo punë bëhet nëpërmjet mbledhjes së të dhënave historike, lejon verifikimin në se gjendja e keqe aktuale e gruas është një përgjigje e fakteve të traumave aktuale, apo në se ajo është riaktivimi i simptomave të shkaktuara nga përsëritja, në kohën e tanishme, të ngjarjeve të traumave të së kaluarës.

Atëherë këshillimi psikologjik lejon edhe zbulimin e sëmundjeve psikopatologjike të rënda të cilat kërkojnë dërgimin në një shërbim psikiatrik.

KËSHILLIMI LIGJOR

Avokate vullnetare vënë në dispozicion kohën dhe profesionin e tyre për t'i dhënë grave, të cilat bëjnë kërkesë, informacionet mbi të drejtat dhe detyrat e caktuara nga e drejta e familjes, si dhe informacione mbi normat e vendosura nga ligjet në fuqi, për t'u mbrojtur nga agresiviteti që kryhet nga bashkëshorti në dëm të tyre.

Futja në qendrat e mbrojtura

Në rastet më të rënda bëhet i nevojshëm aktivimi i një shërbimi i cili, në bashkëpunim me dikasteret përkatëse (Shërbimet Sociale, Kuesturën), merr masa për futjen e gruas, së bashku me fëmijët e saj të mundshëm, në një qendër bujtëse të mbrojtur.